

**AKT I THEMELIMIT  
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"3S Consulting Service Solution Sustainability" sh.p.k**

Sot me date 19.01.2022 une e nenshkruara:

1. Mirsilda Sokoli, lindur ne Kukës, Shqiperi me date 08.11.1989, mbajtese e leternjoftimit nr. **I96108038T**, me zotesi te plote per te vepruar; me ane te ketij dokumenti themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur "**3S Consulting Service Solution Sustainability** sh.p.k, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 1  
Emertimi**

- 1.1 Themelohet nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar **3S Consulting Service Solution Sustainability** (ne vijim e quajtur "Shoqeria")
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar si dhe fiton personalitet juridic ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3 Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me statutin.

**Neni 2  
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen Rruga "Myrteza Kellici, pallati AL-FAM (ngjitur me shkollen Teknike Ekonomike, Tirane) kati 1, njeria nr. 16.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojë filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 3  
Objekti**

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e meposhtme:

- a) Arkitekture dhe Ndertim: Konsulence inxhinjerike, arkitekture, ndertim, studim, projektim, restaurim, projektim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures, veprave





te artit, ndermjetesim i aktiviteteve te projektimit, ndertimit dhe supervizimit te objekteve me interes publik dhe privat.

b) Mjedis, burime ujore, mbetje, eficence e energjise: Vleresime mjedisore dhe sociale, raporte dhe vleresime mbi menaxhimin e burimeve natyrore, ujerave; raporte, studime dhe projekte te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta urbane; raporte mbi auditimin dhe menaxhimin e eficenses se energjise ne ndertesa, ne industri dhe ne transport.

c) Menaxhim i tokes dhe zhvillim i qendrueshem rural: raporte dhe vleresime mbi menaxhimin e tokes dhe zhvillimin e qendrueshem te tokes ne fushen e pyjeve, kullotave dhe tokave bujqesore; hartesim GIS; sherbime konsulence dhe keshillim ligjoro-teknik per te drejtat mbi token, vleresim asetesh, regjistrim, inventarizim, standardizim, hartim planesh menaxhimi, licensim (kombetar dhe nderkombetar) per zhvillimin e qendrueshem rural ne bujqesi, pyje, kullota, peshkim, akuakulture dhe ekoturizem; studime fizibiliteti dhe plane menaxhimi sektoriale dhe strategjike, sherbime plotesuese dhe aktivite te tjera qe lidhem me zhvillimin rural.

d) Vleresim i pasurive te paluajtshme per ndertesa, toke truall, toke bujqesore, toke pyjore, kullote, livadh dhe toke te pafrytshme.

e) Menaxhim dhe asistence biznesi: Analize dhe vleresim i biznesit, i strukturave operative financiare per industri te ndryshme; modelim biznesi, keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financiar, studime tregu, studime mbi plane biznesi, transaksione dhe strategji shitjesh; keshillime mbi partneritete te ndryshme, negocime te termave te marreveshjes dhe vleresime risku; planifikim i investimeve dhe asistence per aplikime fondesh kombetare dhe nderkombetare; ristrukturim i bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistence ne marredheniet me institucionet financiare si dhe bashkepunime me/per sektorin publik.

f) Sherbim ligjor dhe standardizim: Asistence ligjore per leje, autorizime dhe licensime nga organet publike; konsulence ne praktika kontraktuale dhe administrative te nderlidhura me projekte, financime kombetare ose nderkombetare; trajnime dhe rritje kapacitetesh ne fushat e mesiperme te formimit profesional te dedikuara sektorit privat dhe sektorit jo-fitimprures; standardizim i procedurave, rregulloreve e politikave te punes dhe krijimi i sistemeve te motivimit/incentivimit ne organizatat e sektorit privat dhe atij jo-fitimprures; zhvillim i fushatave te ndergjegjesimit, organizim i konsultimit publik, analiza dhe angazhimi i aktoreve, zhvillimi i planeve te komunikimit.

Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo lloj vreprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime ne te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, si dhe mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj.

**Neni 4**  
**Kohezgjatja**





Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar per nje periudhe kohore te pakufizuar. Asambleja e Ortakeve mund te shkurtoje kohezgjatjen e Shoqerise.

## **Neni 5 Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 Lek (njeqind lek), 1 kuote me vlere 100 lek.

Kapitali themeltar ne para eshte nenshkruar nga Ortaku i Vetem i Shoqerise si me poshte:

- Mirsilda Sokoli lindur ne Kukes, Shqiperi me date 08.11.1989, mbajttese e leternjoftimit nr. I96108038T, zoterues e 1 kuote me vlere 100 Lek qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

5.2 Pergjegjesia e ortakeve per detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve shtrihet deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

5.3 I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe zoterohet teresisht nga Ortaket e Shoqerise.

## **Neni 6 Administrimi**

6.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori i vetem:

- a) Mund te mos jete ortak;
- b) Do te ushtroje detyren per nje periudhe qe do te percaktohet kohe pas kohe nga Asambleja e Ortakeve ne aktin e emerimit, e cila ne asnje rast nuk mund te jete me e gjate se 5 vite;

Perjashtimisht, detyren e pare te Administratorit te Vetem do ta ushtroje znj. Mirsilda Sokoli, lindur ne Kukes, Shqiperi me date 08.11.1989, mbajttese e leternjoftimit nr. I96108038T.

Administratori i Shoqerise ushtron kompetencat e tij sic parashikohet nga dispozitat e ligjit.

## **Neni 7 Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor i shoqerise fillon me date Janar dhe mbyllet me date 31 Dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me date 31 Dhjetor 2022.

## **Neni 8 Prishja dhe Likuidimi**





Ne rast prishje dhe likuidimi te Shoqerise, per cfaredo arsye dhe ne cdo moment, Asambleja e Ortakeve do te emeruje lukidatorin ose likuidatoret ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 9**  
**Ligi i Zbatueshem**

9.1 Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do t'i behet shprehimisht reference Statutit te Shoqerise dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare, vecanerisht ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

9.2 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Akti Themelimi si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe ortakeve, apo midis vete ortakeve, qe nuk mund te zgjidhet ne mirekuptim midis tyre, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 10**  
**Te ndryshme**

Ky Akt Themelimi i Shoqerise eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, secila me vlere te njejte, dhe nenshkruar rregullisht nga ortaket.

**ORTAKET THEMELUES**

**ORTAKU**

Mirilda Sokoli 